15. Arkivi i Autoritetit, Fondi 4 Drejtorja e Parë e Sigurimit të Shtetit, Viti 1984, Dosje nr. 370, vendimi nr. 1
16. Arkivi i Autoritetit, Fondi 4 Drejtorja e Parë e Sigurimit të Shtetit, Viti 1989, Dosje nr. 394, vendimi nr. 1
17. Arkivi i Autoritetit, Fondi 4 Drejtorja e Parë e Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, Dosje nr. 704 vendim internim-dëbimi
18. Arkivi i Autoritetit, Regjistër Alfabetik nr. 3 i Internim-Dëbimeve, fq 8-9
19. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtorja e Punëve të Brendshme Tiranë, regjister i Internim-Dëbimeve, fl 23.1-24
20. Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, regjister i Internim-Dëbimeve, Model 17, fl. 2-3
21. Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, regjister i Internim-Dëbimeve, Model 17, fl. 1.1-2
22. Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje nr. 1202.
23. Arkivi i Autoritetit, Fondi Grupet, Dosje pa nr. “Shtriga”, me 309 faqe.
24. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Dosje e problemit të centralizuar nr. 607 “Bloza”, me 642 faqe.
25. Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje nr. 1202, me 10 volume, në ngarkim të L. B
  - a) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje Përpunimi, Vol. nr. I, me 251 faqe
  - b) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje Përpunimi, Vol. nr. II, me 239 faqe.
  - c) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje Përpunimi, Vol nr. III, me 249 faqe.
  - d) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB Elbasan, Dosje Përpunimi, Vol. IV, me 235 faqe.
  - e) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Dosje Përpunimi, Vol. V, me 268 faqe.
  - f) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Dosje Përpunimi, Vol. VI, me 242 faqe.
  - g) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Dosje Përpunimi, Vol. VII, me 207 faqe.
  - h) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Dosje Përpunimi, Vol. VIII, me 227 faqe
  - i) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Dosje Përpunimi, Vol. IX, me 205 faqe.
  - j) Arkivi i Autoritetit, Fondi DPB, Vol. X, me 73 faqe.

Për shtetasen D. Ç

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Operativ, Dosje nr. 3497 në ngarkim të D. M. Ç, me 102 faqe.
2. Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesi/ja, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kërkuesi/ja duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 413, datë 18.09.2025 neni 28, pika “5” “Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruara nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat, përcaktuara dhe dokumenton rezultatit. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse”;
4. Kërkuesi/ja në bashkëpunim me Autoritetin duhet të zbatojë, për aq sa është e mundur, vënien në dijeni e personave/familjareve në zbatim të nenit 36 pika 4 të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar)
5. Kërkuesi/ja zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr.45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr. nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Dr. Gentiana Sula (Në mungesë dhe me urdhër: Anëtar, Altin Hoxha)

**Anëtarë:** Dr. Albert Nikolla, Gjergj Marku, Skënder Vrioni

**Vendim nr. 118, datë 19.02.2026 (i shkurtuar)**

Bazuar në ligjin nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 36, 37, 38, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 413, datë 18.09.2025”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit

**V E N D O S I:**

1. Të vihet në dispozicion për konsultim të kërkuesit W. I. dokumentacioni dublikatë i mëposhtëm:

Për shtetasin A. D (H)

1. Arkiva Autoritetit, Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1989, Dosja nr.313 me 4 faqe.
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Operativ Dosje përpunimi nr.5282 në ngarkim të A. K. H, faqet: 25, 67, 68, 219, 230, 237, 274, 308, 309.

Për shtetasin F. D

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë Regjistër Përpunimi nr. 2/1, konkretisht rreshti me nr. Rendor 5888.
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë Regjistër Përpunimi nr.37, konkretisht rreshti me nr. Rendor 2220.
3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat Regjistër Përpunimi nr.2, konkretisht rreshti me nr. Rendor 1142
4. Arkiva e Autoritetit, Kartelë Model 1 nr. 2220.

Për shtetasit objekt kërkimi: S. H, P. P, J. K dhe M. Zh, B. I të cilët plotësojnë kriterin e pikës “dh” të nenit 36, nga kërkimi i drejtëpërdrejtë me mjetet e kërkimit të disponuara deri më tani, nuk janë identifikuar të dhëna arkivore.

2. Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesi/ja, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kërkuesi/ja duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim nr. 743, datë 19.12.2024 neni 28, pika “5” “Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruara nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i

studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat, përcaktuara dhe dokumenton rezultatin. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse”;

4. Kërkuesi/ja në bashkëpunim me Autoritetin duhet të zbatojë, për aq sa është e mundur,

vënien në dijeni e personave/familjareve në zbatim të nenit 36 pika 4 të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar)

5. Kërkuesi/ja zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr.45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr. nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).

6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Dr. Gentiana Sula (Në mungesë dhe me urdhër: Anëtar, Altin Hoxha)

**Anëtarë:** Dr. Albert Nikolla, Gjergj Marku, Skënder Vrioni



## KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

## RRUFEJA NË SHTËPINË E MIKPRITËSIT, KUJTOJMË HOLOKAUSTIN ME KLUBIN E LIBRIT AIDSSH

Tiranë, 26 janar 2026



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Fondacionin “Besa”, mbajtën Klubin e Librit “Mësojmë nga e kaluara” me diskutimin e romanit “Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit” të shkrimtarit Marçel Hila.

Me praninë e mësuesve të historisë dhe edukimit qytetar, studentë të masterit “Mësues në Histori”, pedagogë, përfaqësues institucionesh, si dhe gazetarë dhe studiues të fushës së historisë dhe kujtesës, takimi ishte një hapësirë reflektimi mbi kujtesën historike, edukimin qytetar dhe përgjegjësinë morale të shoqërisë.

Në fjalën e hapjes, Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, theksoi se Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit nuk është thjesht një datë kalendarike, por një provë morale për shoqëritë dhe një thirrje për kujtesë aktive. Ajo nënvizoi se Shqipëria, në një Evropë të përkulur nga frika, urrejtja racore dhe konformizmi ideologjik, zgjodhi ndryshe: vendosi njeriun mbi politikën dhe jetën mbi urdhrin.

“Rezultati është një fakt historik i pakontestueshëm: Shqipëria është i vetmi vend në Evropë që doli nga Lufta e Dytë Botërore me më shumë hebrenj të shpëtuar sesa kishte përpara luftës. Kjo nuk ishte rastësi, por kulturë morale dhe zgjedhje njerëzore – ishte Besa”, u shpreh znj. Sula.

Ajo vuri theksin gjithashtu te rëndësia e përcaktimit të piketave të kujtesës historike në kurrikulat mësimore, si dhe te përdorimi i burimeve arkivore si instrument edukimi, duke theksuar se dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përbëjnë një burim të çmuar për mësuesit, studiuesit dhe studentët e historisë.

“Në këtë frymë, Klubi i Librit në AIDSSH dhe bashkëpunimi i ri me Fondacionin Besa synojnë të shkojnë përtej përkujtimit simbolik, që Holokausti të mos mbetet një kapitull i largët në tekstet shkollore dhe shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri të mos reduktohet në legjendë folklorike.



Por të kthehet në mësim qytetar, në instrument edukimi kundër urrejtjes, në shembull të zgjedhjes morale edhe sot.

Dosjet e elitës politike, administrative dhe intelektuale të periudhës së Holokaustit ndodhen sot në fondin e ish-Sigurimit të Shtetit, duke përbërë një burim të çmuar për studiuesit dhe mësuesit e historisë. Këto dokumente ofrojnë mundësinë për të njohur më thellë faktet, vendimmarrjet dhe personazhet e kohës – jo përmes mitizimit, as vështrimit bardh-a zi por përmes provës historike.”

Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit “Besa”, z. Albi Grevja, përshëndeti bashkëpunimin institucional me Autoritetin e Dosjeve duke theksuar se edukimi mbi Holokaustin dhe historia e shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri përbëjnë një detyrim moral dhe kulturor për shoqërinë shqiptare dhe më gjerë.



Skënder Vrioni, anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, u ndal në rolin e veçantë të Beratit dhe komunitetit të tij në mbrojtjen dhe strehimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. “Berati, - tha ai, - përfaqëson një nga shembujt më domethënës të bashkëjetesës, tolerancës fetare dhe mikpritjes në historinë shqiptare, ku familje myslimane dhe të krishtera hapën dyert e shtëpive të tyre për hebrenjtë e rrezikuar nga shfarsosja naziste, duke rrezikuar edhe jetën e tyre. Kadri Cakrani, gjatë Luftës së Dytë Botërore, udhëhoqi me guxim mbrojtjen dhe shpëtimin e qindra hebrenjve në qytetin e Beratit, duke rrezikuar jetën e tij dhe të familjes. Me urdhra të prerë dhe organizim të fshehtë, ai siguroi strehim, dokumente dhe mbrojtje për ta, duke mos dorëzuar asnjë hebre pushtues nazistë. Falë veprimit të tij, Berati u shndërrua në një strehë shpëtimi në një nga periudhat më të errëta të historisë evropiane. Sot, Kadri Cakrani nderohet ndërkombëtarisht si një hero i Holokaustit dhe simboli i besës, solidaritetit dhe humanizmit shqiptar.”



Autori Marçel Hila prezantoi librin “Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit”, një vepër që sjell histori konkrete dhe dëshmi njerëzore të familjeve hebreje të strehuara në Shqipëri, ku në qendër qëndron familja me origjinë hebreje Rabinovitz. Përmes rrëfimit letrar, libri kthen kujtesën historike në përvojë të jetuar dhe ngre pyetje thelbësore mbi raportin mes frikës, mbijetesës dhe mikpritjes.

Aktiviteti u moderua nga gazetarja Monika Stafa, autore e librit “Hebrenjtë në Shqipëri”, e cila theksoi se studimi i saj ka pasur si synim të hedhë dritë mbi ekzistencën e komunitetit hebre në Shqipëri që nga antikiteti e deri në vitet ‘90, si dhe të shpjegojë arsyet historike, kulturore dhe shoqërore të bashkëjetesës paqësore mes hebrenjve dhe shqiptarëve.



Sipas Stafës, kjo bashkëjetesë nuk ishte rastësore, por e ndërtaur mbi vlera të rrënjësura thellë në shoqërinë shqiptare, si mikpritja, toleranca fetare dhe respekti për tjetrin, vlera që u shfaqën në mënyrën më domethënëse gjatë periudhës.

Simon Mirakaj, ish-i përndjekur politik, pjesë e bordit të miqve të AIDSSH, vuri në dukje aktet pozitive dhe thellësisht domethënëse që administrata shqiptare e kohës së luftës ndërmori për shpëtimin e hebrenjve nga nazistët. Ai theksoi se kjo datë na vë përballë kujtesës historike dhe ideologjive të çmendura që plagosën hebrenjtë dhe mbarë njerëzimin, ndërsa ende ndiejmë pasojat e rënda të totalitarizmit komunist. Sipas tij, shoqëria jonë shpesh ka frikë të përmendë të vdekurit dhe madhësitinë e veprave të tyre.

Në këtë kuadër, ai përmendi aktin e Kadri Cakranit, i cili strehoi rreth 200 hebrenj gjatë luftës në pronat e tij, si edhe kontributin e Kolë Bibë Mirakës, Mustafa Krujës, Eqerem Bej Libohovës dhe Zef Kadarjes, që nuk ua dorëzuan hebrenjtë pushtuesve, por i strehuan dhe u siguruan pasaporta vendase.



Diskutimi i hapur mes autorit, gazetarëve, mësuesve, studentëve dhe pedagogëve u fokusua në mënyrat se si letërsia, dëshmitë personale dhe dokumentet arkivore mund të përdoren si mjete edukative për të nxitur mendimin kritik dhe për të shmangur banalizimin e së shkuarës.

Në përfundim, u theksua se Klubi i Librit “Mësojmë nga e kaluara” synon të lidhë letërsinë me historinë, arkivat me edukimin qytetar dhe përkujtimin dhe përgjegjësinë, duke e kthyer kujtesën e Holokaustit në një instrument aktiv për formimin e brezave të rinj dhe ndërtimin e një shoqërie më humane, më të drejtë dhe më të ndërgjegjshme.

## NGA DOKUMENTI ARKIVOR DREJT MËSUESIT DHE NXËNËSIT

Tiranë, 27 janar 2026

Datat e Kujtesës po gjejnë gjithnjë e më shumë hapësirë në shkolla, duke u shndërruar nga përkujtim formal në një proces edukimi qytetar aktiv. Përmes tyre, nxënësit dhe mësuesit njihen drejtpërdrejt me pasojat e diktaturës komuniste, jo përmes narrativave ideologjike, por përmes dokumenteve arkivore dhe historive reale njerëzore.

Drejtoresha e Hulmimit Shkencor dhe Edukimit Qytetar, Dr. Ornela Elezi gjatë një intervistë në Vizion Plus theksoi se AIDSSH po ndjek një rrugë të qëndrueshme për të depërtuar në sistemin arsimor, duke e kthyer kujtesën historike në mjet mësimor. Ky proces realizohet përmes përpunimit të dokumentit arkivor dhe përshtatjes së tij në formate edukative të kuptueshme për moshat shkollore.

Në qendër të kësaj qasjeje qëndron platforma digjitale “Mësojmë nga e kaluara”, e cila ofron burime të hapura arsimore për periudhën 1944–1991. Platforma synon të ndihmojë mësuesit në procesin mësimdhënës dhe t’i inkurajojë nxënësit të reflektojnë, të analizojnë dhe të ndërtojnë një raport kritik me të shkuarën, si bazë për edukimin demokratik dhe qytetarinë aktive.



## AIDSSH INICION AKTIVITETIN NJËJAVOR “UDHA E KUJTESËS”

Tiranë, 18 shkurt 2026

Nga data 18 deri në 26 shkurt 2026 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit çel aktivitetin njëjavor “Udha e Kujtesës”. Gjatë kësaj jave mbahen aktivitete kushtuar ditëve të kujtesës; më 20 shkurt ditën e rrëzimit të bustit të diktatorit, intelektualit Lekë Tasi u nderua me titullin “Qytetar nderi” i Divjakës. Po në këtë ditë AIDSSH rihap ekspozitën fotografike “Historitë e patreguara të Lushnjës”, pjesë e projektit “Dinjiteti përballë totalitarizmit”, i mbajtur në vitin 2019 në bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës, ku përmes fotove dokumentohet jeta e të internuarve në fshatrat e zonës: Savër, Plug, Gradishtë, Grabian, Rrapëz, Gjazë, Imsht dhe Çermë, por edhe në zona të tjera si Karavasta, Bedat, Remas, Gërmenj, Hysgjokaj, Bishçukas, Zgjan apo Toshkëz. Kjo ekspozitë qëndron e hapur për një javë. Gjatë “Udhës së kujtesës” do të zhvillohen takime në shkolla dhe vizita të shkollave në AIDSSH, duke u përmbyllur me projeksionin e shfaqjes “Mendje të bukura, shpirtira të lirë” në kuadër të ngjarjes së 26 shkurtit, ditës kur në vitin 1951 u ekzekutuan pa gjyq 22 intelektualë.



## LEKË TASI NDEROHET ME TITULLIN “QYTETAR NDERI” NGA BASHKIA DIVJAKË

Tiranë, 18 shkurt 2025

Në një ceremoni të zhvilluar në ambientet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të 20 shkurtit, ditës së rrëzimit të shtatores së diktatorit u nderua me titullin e nderit shkrimtari dhe ish-i përndjekuri politik Lekë Koço Tasi, për kontributin e tij në dokumentimin e së shkuarës dhe për qëndresën njerëzore përballë padrejtësive.

Titulli iu dorëzua nga nënkryetarja e Bashkisë Divjakë, znj. Silvana Keku, bazuar në vendimin nr. 15, datë 24.02.2025, të Këshillit Bashkiak, me motivacionin: “Për rezistencë dhe dinjitet njerëzor të ish-të përndjekurit, si person aktiv në dokumentimin e së shkuarës”.

Vlerësimi erdhi pas propozimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të angazhimit për të nxjerrë në dritë historitë e panjohura të së kaluarës dhe për të nderuar dëshmitarët e saj.



Po me këtë ceremoni Autoriteti rihapi ekspozitën fotografike “Historitë e patreguara të Lushnjës”, pjesë e projektit “Dinjiteti përballë totalitarizmit”, i mbajtur në vitin 2019 në bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës, ku përmes fotove dokumentohet jeta e të internuarve në fshatrat e zonës, Savër, Plug, Gradishtë, Grabian, Rrapëz, Gjazë, Imsht dhe Çermë, por edhe në zona të tjera, si: Karavasta, Bedat, Remas, Gërmenj, Hysgjokaj, Bishçukas, Zgjan apo Toshkëz, mbledhur dhe dhuruar nga ish-anëtari i Autoritetit, z. Simon Mirakaj.

Në fjalën e saj, kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, e vendosi këtë ceremoni në një kontekst më të gjerë historik, duke lidhur hapjen e ekspozitës, figurën e Lekë Tasit dhe lëvizjen studentore të viteve '90 si shprehje të së njëjtës vlerë: dinjitetit njerëzor përballë padrejtësisë.

Ajo theksoi se Lushnja dhe Myzeqeja për dekada u kthyen në një “kamp të shpërndarë” internimi, ku mijëra familje jetuan nën izolim dhe pa të drejta, ndërsa kujtesa e kësaj historie mbetet ende një detyrë e papërfunduar për shoqërinë shqiptare.

“Internimet mbeten një padrejtësi e gjatë dhe e papërballur plotësisht as nga historiografia, as nga politikat e rehabilitimit.

Sot, këto tri momente, ekspozita, figura e Lekë Tasit dhe lëvizja studentore e vitit 1991, takohen në të njëjtën ide: dinjitetin njerëzor përballë padrejtësisë. Një histori që na mëson se edhe në errësirë ekziston një dritë e triumfit moral dhe se, mbi të gjitha, njeriu mund të mbetet njeri.

Me dorëzimin e titullit tij, z. Lekë Tasi falënderoi për vlerësimin dhe e cilësoi këtë nderim si një thirrje për reflektim shoqëror mbi të kaluarën. Ai theksoi se pasojat e 45 viteve të diktaturës vijojnë të ndihen edhe sot, duke ndikuar në mënyrën si perceptohet historia dhe si ndërtohen marrëdhëniet në shoqëri.

Sipas tij, mungesa e një rishqyrtimi të plotë dhe të paanshëm të kësaj periudhe ka ndikuar në mosvendosjen e drejtë të vlerave dhe figurave historike. Ai vuri në dukje se ende mbeten të pranishme ndikime të mendësive të trashëguara nga historiografia e kohës, të cilat shpesh reflektohen në perceptimet shoqërore.

Megjithatë, z. Tasi theksoi se përtej ideve dhe bindjeve, janë karakteri dhe vlerat njerëzore ato që përcaktojnë marrëdhëniet mes njerëzve. Ai solli shembuj të solidaritetit njerëzor në periudha të vështira për familjen e tij, duke theksuar se pikërisht integriteti dhe ndjeshmëria kanë bërë të mundur mbështetjen mes njerëzve, pavarësisht rrethanave.



Studiues dhe miq të tij, si akademiku Stefan Çapaliku, studiuesi Leka Ndoja e Jozef Radi theksuan se dëshmitë e tij për periudhën e internimeve nuk janë vetëm rrëfime personale, por burime me vlerë për të kuptuar dimensionin njerëzor të asaj kohe. Përmes shkrimeve dhe kujtimeve të tij, ai ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndërtimin e kujtesës kolektive.

Njëkohësisht, doli në pah edhe krijimtaria e tij në pikturë, e cila është vlerësuar nga artistë dhe studiues të artit si një formë e veçantë shprehjeje, ku përvoja jetësore dhe reflektimi personal marrin formë artistike.

Ceremonia u zhvillua në praninë e përfaqësuesve institucionalë, studiuesve dhe qytetarëve, ndërsa ekspozita “Historitë e patreguara të Lushnjës” sjell në vëmendje përmes fotografive dhe dëshmimeve një nga kapitujt më të dhimbshëm të historisë së vendit – internimet masive në zonën e Myzeqesë.



Lekë Tasi u lind më 15 prill 1929. Punoi violonçelist i parë në Orkestrën e Radios dhe të Teatrit të Operës ku u pushua për motive politike në vitin 1967. I ati Koço Tasi, avokat me profesion, i njohur në vitet '20, kishte qenë Anëtar i Parlamentit të Parë Shqiptar pas Kongresit të Lushnjës. Pas Revolucionit të Qershorit, emigroi për 17 vjet në Greqi. Arrestohet dhe dënohet në gjyqin special në vitin 1945. Xhaxhai, Akile Tasi, me karrierë të ngjeshur politike në kohën e luftës, me profesion gazetar, vdiq në burgjet e diktaturës.

Leka u dërgua me punë të detyruar, pak më vonë u internua familjarisht në Grabjan të Lushnjës, 1975-1990. Jetën e kësaj periudhe e ka rrëfyer në librin autobiografik “Grabjani rrëzë kodrave”, Tiranë, 2009, një burim parësor informacioni për brezat e ardhshëm mbi jetën e të internuarve.

Aktiviteti i tij kryesor është piktura. Megjithëse autodidakt, ka punuar seriozisht qysh herët duke kopjuar sipas natyrës dhe duke mësuar nga mjeshtrit e mëdhenj. Pas internimit, në Tiranë më 1990, ai rifillon të pikturojë dhe ka ekspozuar në vitet 1992, 2003, 2007, në Galerinë Kombëtare të Arteve etj.

Vijon edhe sot veprimtarinë aktive për dokumentimin e krimeve dhe pasojave të diktaturës si dhe punon për integrimin shoqëror të njerëzve të goditur në mënyra të ndryshme nga sistemi diktatorial.

## “UDHA E KUJTESËS”- TAKIM ME NXËNËS TË SHKOLLËN JOPUBLIKE TES

Tiranë, 19 shkurt 2026

20 shkurti është një moment i rëndësishëm kujtese, por mbi të gjitha një mundësi për të afruar historinë me brezin e ri. Për këtë arsye, ne e kthejmë këtë datë në një pikë takimi me nxënësit, duke e çuar historinë aty ku ajo duhet të kuptohet më mirë: në shkolla, në hapësirat e edukimit dhe reflektimit.





Vijum me kalendarin “Udha e kujtesës” në shkollën jopublike TES (Tomorrow Education School), ku me nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle diskutuam për të drejtat e njeriut në diktaturë, pas transmetimit të dokumentarit «Ana tjetër e Valiasit».

Dokumentari, prodhim i Autoritetit (2025), flet mbi realitetin e mijëra shqiptarëve të dënuar me internim në kampin e Valiasit dhe kampe të tjera në kohën e diktaturës komuniste.

Me fëmijët foli edhe specialistja e Autoritetit, Vilma Mirakaj, e lindur dhe e rritur në internim, e cila rrëfeu mbi jetën në izolim, vuajtjet, por edhe qëndresën e të gjithë atyre që vuajtën një dënim të padrejtë.



Përgjegjësjë e edukimit, Dr. Brunilda Cërraga, dhe shkrimtarja për fëmijë e AIDSSH-së, Rovena Rrozhani, u ndalën te botimi i librave me këtë temë, të dedikuara për arsimin parauniversitar, pjesë e përmbajtjes së platformës “Mësojmë nga e Kaluara 1944–1991”.

Botimet e AIDSSH-së iu shtuan bibliotekës së shkollës, të cilat, nën kujdesin e drejtoreshës së shkollës, Najada Hoxha, dhe mësueses së përkushtuar të historisë, Yllka Muka, do të kthehen në një burim parësor në mësimin e historisë.

## “UDHA E KUJTESËS”- KLUBI I LIBRIT NË LEZHË

Lezhë, 23 shkurt 2026

Në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, në ambientet e bibliotekës “Gjergj Fishta”, Klubi i Librit në AIDSSH “Mësojmë nga e kaluara” zhvilloi takimin e radhës me librin “Dritë që vjen nga humnera” të Drita Çomos.

Mësues të arsimit parauniversitar, nxënës të shkollave “Hydajet Lezha” dhe “Gjergj Fishta”, studiues të historisë së qytetit dhe anëtarë të Klubit Letrar “Ndoc Gjeta” u mbledhën për të mësuar nga e kaluara përmes “Dritës”.

Znj. Brunilda Cërraga theksoi misionin e Klubit të Librit – afrimin e të rinjve me historinë e periudhës së komunizmit përmes librave dhe një qasjeje më të kuptueshme për ta.



Në emër të bashkisë përshëndeti z. Keler Sufla, duke nënvizuar rëndësinë dhe mbështetjen për aktivitete që forcojnë kulturën e kujtesës.

Znj. Elona Baçi paraqiti historinë e ditarit, botimin dhe dosjen e Drita Çomos në arkivin e ish-Sigurimit të Shtetit, duke shpjeguar për nxënësit çfarë përfaqësonte një dosje dhe mekanizmat e survejimit. Ajo e propozoi librin si një dëshmi unike të diktaturës nga një vajzë e re dhe si një mundësi konkrete pune për mësuesit e historisë, letërsisë dhe sociologjisë.

Studiuesi dhe shkrimtari z. Ernest Marku e vendosi fatin e saj në kontekstin e persekutimit të grave gjatë regjimit komunist, duke përmendur figura si Ramize Gjebrea dhe Liri Belishova, si dhe trajtimin letrar në veprat “E penguar” të Ismail Kadare dhe “Ku je?” të Flutura Aça.

Diskutimet sollën reflektime të vryera. Mësuesja Liza Bunga, mësuese në shkollën “Hydajet Lezha” theksoi: “Rasti i Drita Çomos na ndihmon të kuptojmë dimensionin njerëzor të diktaturës. Përndjekja nuk ishte vetëm dënim fizik; ajo ishte dënim social, heshtje kulturore dhe shkatërrim i perspektivës personale. Nëpërmjet historisë së saj, shohim sesi sistemi



totalitar ndërhynte deri në intimitetin e jetës familjare, duke ndëshkuar jo vetëm individin, por brezat.”

Z. Hekuran Koka u shpreh: “Libri na ofron përjetime të holla, delikate dhe një forcë për ta parë jetën në sy sado e ashpër qoftë ajo.”

Ndërsa znj. Trëndafille Malshi vlerësoi mesazhin frymëzues të autore: “Edhe pse jeta e saj ishte e shkurtër dhe e kufizuar, ajo e jetoj çdo moment me aq sa e lejuan, me aq sa pati mundësi, pa u ankuar dhe quravitur. Eci pa u kufizuar në përpjekje për t’u realizuar edhe pse e dinte se nuk i ofroheshin shumë mundësi.”



Gazetari z. Martin Dedaj e cilësoi librin si “një dëshmi autentike njerëzore që bashkon dokumentimin jetësor me artin poetik duke u lexuar njëkohësisht si ditar, poezi e dhimbjes, meditim mbi jetën.”

Znj. Ana Pali, mësuese në shkollën “Hydajet Lezha” solli dëshmi personale nga kampi i internimit në Fishtë, duke theksuar rëndësinë e dokumentimit dhe punës me të rinjtë, në mënyrë që kujtesa të mbetet e gjallë dhe e vetëdijshme.

Z. Bardhok Lleshi, mësues në shkollën “Hydajet Lezha” u ndal te mënyra sesi e shkuara duhet t’i përcillet brezit të ri: “Duhet të sqarohet se nuk ishte një sistem i ngritur vetëm nga lideri, por kishte kontributin dhe in-diferencën e shumë të tjerëve. Kjo kulturë e njëshit nuk duhet të trashëgohet edhe në ditët e sotme. Duhet të thuhet e vërteta, sepse mungesa e të vërtetës po e zgjat edhe më shumë tranzicionin.”

Në përmbyllje, znj. Brunilda Çërraga ritheksoi rëndësinë e reflektimit mbi të kaluarën dhe përgjegjësinë për t’ia transmetuar këtë mision brezit të ri – i cili jo vetëm që nuk e njeh plotësisht atë periudhë, por rrezikon të mos e kuptojë në shoqëria bëhet e pavëmendshme. Sepse kujtesa është dritë që nuk duhet të shuhet.



## TAKIM NË HAGË: AIDSSH DHE ICMP DREJT NJË PLANI 10-VJEÇAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Hagë, 24 Shkurt 2026

Në zyrat qendrore të International Commission on Missing Persons (ICMP) u zhvillua një takim zyrtar ndërmjet përfaqësuesve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe drejtuesve të ICMP, me fokus forcimin e bashkëpunimit për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri, në përputhje me parimet e sundimit të ligjit.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e Dr. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH, drejtuesve të ICMP të kryesuar nga znj. Kathryn Bomberger, si dhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Erion Mile dhe z. Saimir Korreshi.



Në fjalën e saj, znj. Bomberger theksoi se trajtimi i rasteve të personave të zhdukur kërkon një qasje të qëndrueshme të sundimit të ligjit, ku hetimet administrative dhe institucionale duhet të vijojnë pavarësisht kohës së kaluar, në përputhje me praktikën dhe përvojat ndërkombëtare.

Gjatë prezantimit, Dr. Gentiana Sula paraqiti hapat e ndërmarrë nga AIDSSH, mandatin ligjor aktual, numrin në rritje të kërkesave nga familjarët, veprimet joinvazive të realizuara në terren, si dhe vështirësitë ligjore dhe procedurale që ndikojnë në ritmin dhe efektivitetin e procesit.

Anëtarët e Autoritetit evidentuan nevojën për qartësim të mëtijshëm të kuadrit ligjor dhe nënligjor, forcim të kapaciteteve institucionale dhe përcaktim më të qartë të roleve ndërinstitucionale, me qëllim përmbushjen efektive të mandatit të AIDSSH.

Deputetët e pranishëm shprehën mbështetjen e tyre për ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe institucionale, duke theksuar rëndësinë kombëtare të këtij procesi dhe nevojën për rezultate konkrete për familjarët.

Gjatë takimit, AIDSSH dhe ICMP u dakordësuan për: hartimin e një raporti vlerësimi mbi situatën aktuale, përgatitjen e një plani veprimi 10-vjeçar për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e procesit të gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur.

Në përfundim të takimit, u nënshkrua Marrëveshja e Përdoruesit Fundor (EULA) për përdorimin e sistemit IDMS, e cila rregullon aksesin, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufizon përdorimin e informacionit vetëm për qëllime zyrtare.

Në vijim të agjendës së vizitës në Hagë, u zhvillua gjithashtu një takim informues dhe koordinues në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë, ku u shkëmbyen informacionet mbi ecurinë e bashkëpunimit me ICMP dhe u diskutuan hapat e mëtijshëm që mund të ndërmerren për avancimin e këtij procesi, në koordinim me institucionet përkatëse.

Takimi në Hagë shënon një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për trajtimin e çështjes së personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.



## “TË MËSOJMË NGA E KALUARA” – HISTORIA QË NA FLET SOT

Tiranë, 10 dhe 25 shkurt 2026

Bashkëpunimi ynë me shkollat vazhdon fuqishëm për t'i afruar nxënësit me historinë dhe për t'i ndihmuar të kuptojnë rëndësinë e reflektimit mbi të kaluarën. Të mësuarit nga e kaluara nuk është thjesht një njohuri, është një mundësi për të kuptuar se si vendimet e dikurshme formojnë botën që na rrethon.

AIDSSH mirëpret klasat në institucionin tonë, ku nxënësit dhe mësuesit marrin pjesë në një mësim të simuluar, duke përjetuar historinë dhe duke u informuar drejtpërdrejt nga ekipi ynë. Kjo mënyrë e veçantë e mësimin e bën të kaluarën më të prekshme, ndërgjegjësuese dhe frymëzuese për të rinjtë.



Sipari i këtij vitit u dha në Shkollën 9-vjeçare “Jeronim de Rada”, me prezencën e drejtoreshës znj. Entela Alushi dhe mësueses së historisë, Jonida Vrapit, si dhe mbështetjen e ekipit të AIDSSH-së. Falë këtij bashkëpunimi, nxënësit fituan një eksperiencë të gjallë që i afron më shumë me të kaluarën dhe mesazhet e saj, duke reflektuar mbi përgjegjësitë e tyre sot.

## “UDHA E KUJTESËS”- SHFAQJA “MENDJE TË BUKURA, SHPIRTRA TË LIRË”, DISKUTIM ME NXËNËS TË SHKOLLAVE

Tiranë, 26 shkurt 2026

Aktiviteti njëjavor “Udha e Kujtesës”, i organizuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), uli siparin me projektionin e shfaqjes teatrale “Mendje të bukura, shpirtira të lirë”, për nxënës dhe mësues të shkollave “1 Maji” dhe “Albanët”.

Në kuadër të këtij aktiviteti, nxënësit patën mundësinë të njiheshin me një nga ngjarjet më të rënda të historisë së diktaturës komuniste. Ata u informuan mbi ngjarjet e shkurtit 1951, kur një shpërthim në Ambasadën Sovjetike u përdor si pretekst për arrestimin dhe ekzekutimin pa gjyq të 22 intelektualëve shqiptarë, mes tyre edhe shkencëtarja e parë shqiptare, Sabiha Kasimati. Kjo pjesë u prezantua nga përgjegjësjja e sektorit në Drejtorinë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, dr. Brunilda Çërraga.



Më tej, regjisorja e shfaqjes, Suela Bako, theksoi rëndësinë e artit si një mjet i fuqishëm për të përcjellë historinë, ndërsa autorja e dramës, Rovena Rozhani, zhvilloi një bashkëbisedim interaktiv me nxënësit, duke u ndalur në jetën dhe kontributin e Sabiha Kasimatit.

Shfaqja “Mendje të bukura, shpirtira të lirë”, e ndjekur nga 41 nxënës dhe 4 mësues, është një projekt artistik i ideuar nga mësuesja e ndjerë Ina Kasimati, e cila kërkoi realizimin e një veprë kushtuar tre grave shkencëtare: Sabiha Kasimati, Marie Curie dhe Rosalind Franklin. Edhe pse nuk u njohën kurrë me njëra-tjetrën, ato përfaqësojnë modele të qëndrësës dhe kontributit në shkencë, përballë patriarkatit dhe, në rastin e Kasimatit, edhe diktaturës.

Pas shfaqjes, nxënësit dhe mësuesit zhvilluan një bashkëbisedim me autoren dhe regjisoren, duke reflektuar mbi rolin e artit në njohjen e historisë, si dhe mbi figurën e Sabiha Kasimatit si shkencëtare dhe simbol i dinjitetit njerëzor.



Mësuesit e pranishëm vlerësuan aktivitetin si një formë të suksesshme të ndërthurjes së historisë me artin. Mësuesja e historisë në shkollën “1 Maji”, Mireta Nasto, e cilësoi shfaqjen si një përvojë që integron në mënyrë të natyrshme historinë, shkencën dhe artin, duke sjellë reflektim mbi të kaluarën. Ndërsa mësuesja Anila Goduni theksoi se përcimi i historisë përmes artit rrit vëmendjen dhe përfshirjen e nxënësve. Koordinatorja e karrierës, Erina Dervishi, u shpreh se aktivitete të tilla ndihmojnë në nxitjen e pasionit dhe të mendimit kritik te të rinjtë.

Autorja e dramës, Rovena Rozhani, theksoi se përmes kësaj veprë janë evidentuar betejat e grave në shkencë, përballë paragjyqimeve dhe sistemeve shtypëse, duke veçuar figurën e Sabiha Kasimatit si një shembull i guximit për të thënë të vërtetën dhe për të mbrojtur lirinë dhe dinjitetin.

Ndërsa regjisorja Suela Bako vlerësoi dimensionin njerëzor të projektit, duke kujtuar se kjo shfaqje u realizua edhe si një amanet i mësueses Ina Kasimati, e cila, pavarësisht sfidave personale, kërkoi të linte një mesazh frymëzues për brezat e rinj.

Përmes aktiviteteve të tilla, AIDSSH synon të afrojë historinë me brezin e ri, duke e bërë atë më të kuptueshme dhe më të prekshme përmes ndërthurjes së dokumentit, dëshmisë dhe artit. Për më tepër reflektimet e mësuesëve, autores dhe regjisores pas shfaqjes:



Mireta Nasto, mësuese e historisë në shkollën “1 Maji” – “Nuk e prisja që të ishte një shfaqje kaq e bukur. Si mësuese historie, shumë e dhënë në studimin e historisë sonë dhe të pjesës së errët, të diktaturës ku jemi rritur pashë shkencën, pashë artin, pashë historinë, të integruara shumë bukur dhe të sillen me pasion nga të rinjtë. U impresionova. Ju ndoshta ishit më shumë në fushën e artit, por ne shohim veten të vendosur në atë sistem dikur. Edhe fjalët e Sabihës përballë diktatorit janë shumë domethënëse, të kuptuara në atë kohë janë me shumë rëndësi, ndërkohë që të tjerët nuk e kuptonin dot se ajo që po ndodhte ishte diktaturë.”

Anila Goduni, mësuese e historisë në shkollën jopublike “Albanët” – “Sa herë që vij në këtë institucion (AIDSSH) kam pasur vlerësim. Edhe unë që jam mësuese sot, gjithmonë mësoj nga diçka të re. kështu që për ju ka shumë më tepër për të mësuar. Kur vjen nëpërmjet artit është akoma më e bukur, sepse sjell vëmendjen më të madhe, sjell argëtim tek ju, por ndoshta edhe përqendrimin që ju duhet më tepër. Mendoj se kombinimi i historisë me artin siç erdhi në këtë formë ishte gjëja më e realizuar. Urime!”



Erina Dervishi, koordinatorë e karrierës në shkollën “1 Maji” – “Unë jam mësuese e anglishtes, por mbuloj edhe rolin e koordinatorë së karrierës dhe shpeshherë jam në kërkim të këtyre aktiviteteve sepse dua që të nxis te fëmijët, pasionin që duket se ndonjëherë nuk e stimulojmë sa duhet dhe ky aktivitet sot vërtet na mbushi të gjithëve shpirtërisht. Jam shumë e lumtur dhe ju uroj shumë suksese të gjithëve që bëtë këtë realizim të shfaqjes. Kishin merak disa nga fëmijët se po thoshin që mund të humbasin ndonjë orë fizike apo kimie, por më bukur se kjo shfaqje që tregoi kaq shumë dhe u realizua edhe lënda e kimisë dhe fizikës, nuk ka. Duhet të dalim jashtë kornizave për të kuptuar artin e vërtetë. Suksese pafund! Na kënaqët!”

Rovena Rozhani, autore e dramës – “Janë zgjedhur pikat kyçe që identifikonin betejat e këtyre 3 grave në kohën e tyre, si patriarkati në shkencë dhe diktatura. Veçoj, Sabihanë, e cila la të ardhmen e saj jashtë për t’u rikthyer në një Shqipëri të pas luftës së dytë botërore me qëllimin për të dhënë kontributin e saj në shkencën shqiptare. Por iu desh të përballlej me diktaturën. Tek Sabiha Kasimati kemi dinjitetin e një shkencëtareje që nuk zgjodhi të heshte, por të thoshte të vërtetën, të fliste për lirinë, për të drejtat e njeriut dhe demokracinë.”

Suela Bako për Ina Kasimatin pas shfaqjes – “Besojmë se diku në univers janë shpirtrat dhe kjo është korniza e këtyre tri grave që nuk janë më mes nesh, por ndoshta i ka bashkuar qielli. Dhe Ina duhet të jetë aty dhe e merr këtë energji tani, me shpresën e Zotit. Ka qenë një moment shumë delikat, sepse Ina vetë ka qenë duke u kuruar për sëmundjen e saj, e cila i mori edhe jetën, dhe misioni u bë vërtet shumë sfidues, sepse ne duhet ta bënim për hir të Inës dhe duhej të dilte një shfaqje shumë e mirë për hir të saj. Jam shumë e lumtur që shfaqja ka dalë vërtet shumë e mirë, duke përfshirë edhe misionin që kishte në brendësi të saj.

Nuk ishte e lehtë t’i bënim këto elemente bashkë, për faktin që nuk i bashkon as gjeografia dhe as historia; nuk i bashkon as lloji i shkencës. Por unë besoj se ju nuk ndjetë ndonjë ngërç në kalimet nga një personazh te tjetri. Në fakt, çfarë i bashkon? I bashkojnë arritjet e grave në shkencë.

Ne mund të veçonim vetëm këto tri gra, por sigurisht që janë edhe 3003 gra të tjera që nuk mund të përfshihen në një shfaqje. Por besoj se, nëse ju jeni ngacmuar ose frymëzuar sadopak, mund të bëni bashkë tri të tjera ose bashkëkohëset tuaja, për të dhënë një shembull të jashtëzakonshëm të grave në shkencë.”





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

---

Adresa: Njësia Administrative nr. 4  
Rruga "Kongresi i Manastirit", Garnizoni "Skënderbej", Tiranë